

# Sistemi arsimor në Greqi



## **Pasqyra e përgjithshme e Kretës:**

Kreta është ishulli më i madh dhe më i populluar nga ishujt grekë, ishulli i 88-të më i madh në botë dhe ishulli i pestë më i madh në Detin Mesdhe, pas Sicilisë, Sardenjës, Qipros dhe Korsikës.

Njerëzit kanë banuar në ishull prej të paktën 130,000 vjet më parë, gjatë epokës paleolitike. Kreta ishte qendra e qytetërimit të parë të përparuar të Evropës, e Minoanëve, nga viti 2700 deri në 1420 para Krishtit. Qytetërimi Minoan u tejkalua nga qytetërimi mikenas nga Greqia kontinentale. Kreta u qeveris më vonë nga Roma, në vazhdim rradhazi nga Perandoria Bizantine, nga Arabët e Andaluzisë, nga Republika Veneciane dhe Perandoria Osmane. Kreta, në vitin 1898, populli i së cilës dëshironte për një periudhë kohore të bashkohej me shtetin grek, arriti pavarësinë e saj nga osmanët, duke u bërë zyrtarisht Shteti i Kretës. Kreta u bë pjesë e Greqisë në dhjetor të vitit 1913.

## **Pikat kryesore të sistemit arsimor**

Ofrimi i arsimit falas për të gjithë qytetarët, në të gjitha nivelet, në shkollat shtetërore përbën parim kushtetues të Shtetit Grek. Sistemi arsimor grek është i centralizuar. Ai rregullohet nga legjislativi dhe aktet legjislative (dekrete, vendime ministrash).

## **Niveli Qendror**

**Në nivel qendror,** Ministria e Arsimit dhe Feve ka përgjegjësinë administrative të sistemit arsimor në të gjitha fushat, shërbimet dhe nivelet.

Merr vendimet thelbësore që lidhen me objektiva afatgjata. Gjithashtu, rregullon çështje të ndryshme, si përcaktimin e përmbajtjes së programit mësimor, emërimin e personelit mësimor dhe kontrollin e financimit.

## **Niveli rajonal dhe lokal**

**Në nivel rajonal,** drejtoritë arsimore rajonale mbikëqyrin zbatimin e politikës arsimore kombëtare.

**Në nivel lokal,** drejtoritë e arsimit fillor dhe të mesëm mbikëqyrin të gjitha shkollat e fushës së tyre të përgjegjësisë. Së fundi, njësitë shkollore kujdesen për funksionimin e rregullt të tyre.


# Ελλάδα - 2020/21

Ηλικία των μαθητών

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 11 12 13 14 15 16 17 18 19 20 21 22

Διάρκεια προγράμματος (έτη)

0 1 2 3 4 5 6 7 8



EL\_C

(1) Το πρόγραμμα καταργείται σταδιακά μεταξύ 4 και 5 ετών από το 2020/21.

Σημειώσεις: Ο νόμος 4521/2018 καθιέρωσε το διετές υποχρεωτικό νηπιαγωγείο (προσχολικό). Η εφαρμογή του μέτρου εκτείνεται σε τριετή περίοδο από το 2018 έως το 2021. Το σχολικό έτος 2020/21 (τρίτο και τελευταίο έτος εφαρμογής του) προβλέπει την υποχρεωτική παρακολούθηση όλων των προσχολικών σε όλους τους δήμους της χώρας. Εν τω μεταξύ, για ένα χρόνο πέρυσι, οι Βρεφονηπιακοί σταθμοί και οι Παιδικοί σταθμοί θα συνεχίσουν να φιλοξενούν παιδιά ηλικίας έως 5 ετών.

- |  |  |
|--|--|
| Προσχολική αγωγή και εκπαίδευση (για την οποία το Υπουργείο Παιδείας και Θρησκευμάτων δεν είναι αρμόδιο) | Δευτεροβάθμια επαγγελματική εκπαίδευση       |
| Προσχολική αγωγή και εκπαίδευση (για την οποία το Υπουργείο Παιδείας και Θρησκευμάτων είναι αρμόδιο)     | Μετα-δευτεροβάθμια μη τριτοβάθμια εκπαίδευση |
| Πρωτοβάθμια εκπαίδευση   | Γενική δευτεροβάθμια εκπαίδευση              |
|  | Τριτοβάθμια εκπαίδευση (πλήρους φοίτησης)    |

Αντιστοιχία με τα επίπεδα ISCED 0 ISCED 1 ISCED 2 ISCED 3 ISCED 4 ISCED 5 ISCED 6 ISCED 7

- |   |                       |  |  |
|---|-----------------------|--|--|
| Πλήρους φοίτησης υποχρεωτική εκπαίδευση | Επιπλέον έτος         | Συνδυασμός σχολείου και μαθημάτων στον χώρο εργασίας | Σταδιακή κατάργηση προγράμματος κατά τη διάρκεια του έτους |
| Μερικής φοίτησης υποχρεωτική εκπαίδευση | Σπουδές στο εξωτερικό | -/η/- Υποχρεωτική εργασιακή εμπειρία + διάρκεια      |  |

Ηλικία των μαθητών - Mosha e nxënësve  
Διάρκεια προγράμματος - Kohëzgjatja e programit (vite)

Νηπιαγωγείο – Kopshti i fëmijëve  
Δημοτικό Σχολείο – Shkolla fillore  
Γυμνάσιο – Gjinnazi  
Γενικό λύκειο – Shkolla e mesme e përgjithshme

Πανεπιστήμιο – Universiteti  
Τεχνολογικό Εκπαιδευτικό Ίδρυμα - Instituti Arsimor Teknologjik

Παιδικός σταθμός : Kopsht  
Βρεφονηπιακός Σταθμός – Çerdhe  
Βρεφικός Σταθμός – Kopsht  
Εσπερινό Γυμνάσιο – Gjinnaz i mbrëmjes  
Εσπερινό Γενικό Λύκειο – Shkollë e mesme e mbrëmjes  
Επαγγελματικό Λύκειο – Shkollë profesionale  
Εσπερινό Επαγγελματικό Λύκειο – Shkollë profesionale e mbrëmjes  
Ινστιτούτο Επαγγελματικής Κατάρτισης - Institut i Formimit Profesional

(1) Το πρόγραμμα καταργείται σταδιακά – Programi shfuqëzohet gradualisht midis 4 dhe 5 vjeç nga viti 2020/21.

**Σημειώσεις:** Ligji 4521/2018 vendosi kopshtin e detyrueshëm dyvjeçar (parashkollor). Zbatimi i masës shtrihet në një periudhë trevjeçare nga viti 2018 deri në vitin 2021. Viti shkollor 2020/21 (viti i tretë dhe i fundit i zbatimit të tij) parashikon frekuentimin e detyrueshëm të gjithë parashkollorëve në të gjitha bashkitë e vendit. Ndërkohë, vjet, për një vit, Çerdhet dhe Kopshtet do të vazhdojnë të mikpresin fëmijë të moshës deri në 5 vjeç.

Προσχολική αγωγή .....δεν είναι αρμόδια – Edukimi dhe arsimit parashkollor (për të cilën Ministria e Arsimit dhe Fëve nuk është kompetente)

Προσχολική αγωγή ..... είναι αρμόδια – Edukimi dhe arsimit parashkollor (për të cilën Ministria e Arsimit dhe Fëve është kompetente)

Πρωτοβάθμια εκπαίδευση – Arsimit fillor  
Γενική δευτεροβάθμια εκπαίδευση - Arsimit i mesëm i përgjithshëm  
Δευτεροβάθμια επαγγελματική εκπαίδευση - Arsimit i mesëm profesional  
Μετά - δευτεροβάθμια μη τριτοβάθμια εκπαίδευση - Arsimit pas arsimit sekondar jo arsim i lartë  
Τριτοβάθμια εκπαίδευση (πλήρους φοίτησης) - Arsimit i lartë (me kohë të plotë)  
Αντιστοιχία με τα επίπεδα – Respektivisht me nivelet

Πλήρους φοίτησης υποχρεωτική εκπαίδευση – Arsim i detyrueshëm me kohë të plotë

Επιπλέον έτος – Vit shtesë

Συνδυασμός σχολείου και μαθημάτων στον χώρο εργασίας - Kombinim i shkollës dhe mësimene në vendin e punës

Μερικής φοίτησης υποχρεωτική εκπαίδευση - Arsimi i detyruar me kohë të pjesshme

Σπουδές στο εξωτερικό – Studime jashtë shtetit

Υποχρεωτική εργασιακή εμπειρία + διάρκεια - Përvojë e detyrueshme pune + kohëzgjatja

Σταδιακή κατάργηση προγράμματος κατά την διάρκεια του έτους - Shfuqizimi gradual i programit gjatë vitit

## **Organizimi i sistemit arsimor**

Çerdhet dhe kopshtet përbëjnë arsimin parashkollor. Mbikëqyrja e funksionimit të tyre i takon bashkive. Regjistrohen fëmijë parashkollorë nga mosha 2 muajshe deri në moshën e regjistrimit në arsimin e detyrueshëm.

### **Arsimi i detyrueshëm në Greqi përfshin:**

- Arsimin e detyrueshëm dyvjeçar për fëmijë 4 dhe 5 vjeç në kopsht.
- Frekuentimin gjashtëvjeçar të nxënësve në shkollën fillore.
- Frekuentimin trevjeçar të nxënësve në gjimnaz

Fazat e arsimit grek janë kryesisht 3:

### **Arsimi fillor**

Arsimi fillor përfshin Kopshtet dhe Shkollat fillore.

### **Kopshti**

Arsimi parashkollor në Greqi është i detyrueshëm për fëmijët që kanë mbushur vitin e 4-të të moshës së tyre nga viti shkollor 2018/19. Në vitin shkollor 2020/21 pritet të përfundojë dhe integrimi i bashkive të fundit të vendit në arsimin e detyrueshëm dyvjeçar.

Qëllimi i kopshtit është të ndihmojë fëmijët të zhvillohen fizikisht, emocionalisht, mentalisht dhe socialisht dhe në veçanti:

1. Të zhvillojnë shqisat dhe të organizojnë veprimet e tyre motorike dhe mendore.
2. Të pasurojnë dhe organizojnë përvojat e tyre nga mjedisi natyror dhe social dhe të fitojnë aftësinë për të dalluar marrëdhëniet dhe ndërveprimet që ekzistojnë brenda tij.
3. Të zhvillojnë aftësinë e të kuptuarit dhe shprehjes me simbole në përgjithësi dhe në veçanti në fushën e gjuhës, matematikës dhe estetikës.
4. Të krijojnë marrëdhënie ndërpersonale, të cilat do t'i ndihmojnë në integrimin e tyre gradual dhe harmonik në shoqëri.
5. Të marrin iniciativa lirshëm dhe pa mundim brenda mjedisit të organizuar dhe të përshtaten me marrëdhëniet e dyanshme të individit dhe grupit.

Kurrikula e arsimit parashkollor dhe materiali mbështetës edukativ përkatës është hartuar nën mbikëqyrjen e Institutit të Politikave Arsimore (IPA) dhe miratohet nga Ministria e Arsimit.

Për programin e detyrueshëm të arsimit parashkollor publik (kopsht): ligji 4692/2020 me vendim të Ministrit të Arsimit dhe të Feve, i cili del pas propozimit të Institutit të Politikës Arsimore, insertohet:

- një aktivitet edukativ i titulluar "Laboratorë të Aftësive", i cili konsiston në suplementin pilot të kurseve të reja tematike në kopshtin e fëmijëve. Qëllimi është të përmirësohen soft skills, life skills dhe aftësitë teknologjike dhe shkencore.
- një aktivitet edukativ për angazhimin krijues të nxënësve në gjuhën angleze nëpërmjet organizimit dhe realizimit të aktiviteteve. Gjatë këtyre, nxënësit ndërveprojnë me mësuesit e anglishtes (PIE06) në prani të mësueses së kopshtit.

Më konkretisht, aktiviteti pilot vendos për herë të parë aplikimin e "Laboratorëve të Aftësive" në Arsimin Fillor dhe të Mesëm.

Arsimi fillor - Shkolla fillore është faza vijuese, e cila zgjat deri në 6 vjet. Përfshin fëmijët e moshës 6-12 vjeç.

Nga viti shkollor 2016/17 ekziston vetëm një lloj shkolle me orar të ri të revizionuar ditor. Në këtë kontekst, të gjitha shkollat parashkollore dhe fillore ofrojnë një program opsional gjithëditor. Shkollimi fillor zgjat 6 vjet. Ai përfshin klasat A, B, C, D, E dhe F. Nxënësit gjashtëvjeçarë regjistrohen në klasën e parë të shkollës fillore.

Lëndët mësimore të shkollës fillore të tipit të unifikuar gjithëditor janë:

1. Edukatë fetare
2. Gjuhë
3. Matematikë
4. Histori
5. Studimi i Mjedisit
6. Gjeografi
7. Shkenca natyrore
8. Edukatë qytetare
9. Edukim artistik (Arte pamore, Muzikë, Dramë)

10. Edukim fizik

11. Anglisht

12. Gjuhë e huaj e dytë

13. Zonë fleksible

14. TIK

Qëllimi i shkollës fillore, sipas [ligjit 1566/1985](#), është zhvillimi i shumëanshëm mendor dhe fizik i fëmijëve dhe në veçanti:

1. Të zgjerojnë dhe të riorganizojnë marrëdhëniet e veprimtarisë së tyre krijuese me sendet, situatat dhe dukuritë që studiojnë.
2. Të ndërtojnë mekanizmat që kontribuojnë në përvetësimin e njohurive, të zhvillohen fizikisht, të përmirësojnë shëndetin e tyre fizik dhe mendor.
3. Të përvetësojnë përmbajtjen e koncepteve më themelore dhe të fitojnë gradualisht aftësinë për të kaluar nga të dhënat e shqisave në fushën e mendimit abstrakt.
4. Të fitojnë aftësinë për të përdorur drejt të folurit me gojë dhe me shkrim.
5. Të familjarizohen gradualisht me vlerat morale, fetare, kombëtare, humanitare e të tjera dhe t'i organizojnë ato në një sistem vlerash.
6. Të kultivojnë kriteret e tyre estetike, në mënyrë që të vlerësojnë veprat e artit dhe të shprehën në përputhje me rrethanat, nëpërmjet krijimeve të tyre artistike.

Shkolla gjithëditore opsionale në shkollën fillore synon në shfrytëzimin pedagogjik të kohës që kalojnë nxënësit pasditeve në shkollë. Rrjedhimisht, redukton barrën financiare të familjes. Prindërit nuk kanë nevojë të kërkojnë shërbime arsimore shtesë përtej mjedisit shkollor.

Bashkëformësimi i objektivave arsimore, i praktikave pedagogjike dhe i formave të provimit dhe vlerësimit formues nga njësitë shkollore dhe grupet shkollore, në bashkëpunim me (QMAK) (Qendrat Mbështetëse Arsimore dhe Këshillimore), QEM (Qendrat e Edukimit Mjedisor) dhe QRPA(Qendrat Rajonale të Projektimit Arsimor) presim që të krijojnë një dinamikë të re në sistemin arsimor grek.

Krahas arsimit fillor publik, funksionojnë edhe shkolla private të arsimit fillor.

## **Arsimi i mesëm**

Arsimi i mesëm përfshin dy cikle studimesh:

### **Gjinnazi**

I pari është i detyrueshëm dhe korrespondon me Gjinnazin:

- Zgjat 3 vjet



- Ofron arsim të përgjithshëm
- Mbulon moshat 12-15
- Është parakusht për regjistrim në Shkollën e Mesme të Përgjithshme dhe Shkollën e Mesme Profesionale
- Gjimnazet e mbrëmjes funksionojnë paralelisht me gjimnazet e ditës, në të cilat frekuentimi fillon nga mosha 14 vjeçare.

### **Shkolla e mesme**

Cikli i dytë i studimeve të arsimit të mesëm nuk është i detyrueshëm dhe përfshin Shkollat e Mesme të Përgjithshme dhe Shkollat e Mesme Profesionale.

- Zgjat tre vjet
- Nxënësit regjistrohen në moshën 15 vjeçe

Më konkretisht, arsimit të përgjithshëm jo i detyrueshëm ndahet në:

- a. Shkolla të mesme të përgjithshme. Është një program trevjeçar që përfshin mësim të arsimit të përgjithshëm dhe mësim orientues.
- b. Shkolla të Mesme Profesionale. Shkolla e mesme profesionale ofron dy cikle studimesh:

Cikli sekondar opsional, cikli arsimor pas arsimit të mesëm, i ashtuquajtur "klasa e praktikës". Paralelisht me shkollat e ditës, funksionojnë:

- a. Shkollat e mesme të përgjithshme të mbrëmjes
- b. Shkollat e mesme profesionale të mbrëmjes.

### **Arsimi i lartë**

Arsimi i lartë është niveli i fundit i sistemit të arsimit formal. Studimet universitare zakonisht zgjasin 4 vjet, ndërsa programet pasuniversitare një deri në dy vjet dhe programet e doktoraturës të paktën 3 vite kalendarike.

**Përfshin sektorin universitar:**

- Universitete
- Universiteti Politeknik
- Shkolla e Arteve të Bukura

### **Mësimi Permanent**


Mësimi Permanent në Greqi zhvillohet në qendrat e Mësimi Permanent, të cilat zakonisht mbikëqyren nga shërbimet bashkiake. Këto qendra ofrojnë një shumëllojshmëri mësimesh, që synojnë sa në edukimin formal aq dhe në atë joformal. Nga ana tjetër, Institutet e Formimit Profesional dhe Shkollat e Formimit Profesional shpesh përshtatin kurrikulën e tyre për t'iu

përputhur nevojave të nxënësve të tyre të rritur dhe tregut të punës. Së fundi, Shkollat e Arsimit për të Rritur të Shansit të Dytë u drejtohen atyre nxënësve që kanë braktisur shkollën në një moment të jetës së tyre, por dëshirojnë të vazhdojnë studimet e tyre më vonë.

### **Sistemi arsimor grek dhe integrimi**

Sistemi arsimor grek bazohet në parimin e integritit, sepse fëmijët emigrantë dhe refugjatë shkollohen në shkolla ku frekuentojnë nxënës greqishtfolës. Kështu, ekzistojnë klasa për emigrantët dhe fëmijët e refugjatëve në shkolla në 39 shkolla fillore në rrethin Heraklion, të cilat janë të shpërndara në të gjithë prefekturën, si në qendër ashtu edhe në brendësi (2020-2021).

Ekzistojnë 2 klasa për nxënësit emigrantë dhe refugjatë, klasa 1 dhe klasa 2. Klasa 1 u drejtohet nxënësve që nuk njohin ose nuk flasin aspak gjuhën greke, ndërsa klasa 2 u drejtohet nxënësve që mund të komunikojnë greqisht edhe në formën bazë.



Drejtoria e Arsimit Fillor Heraklion synon në menaxhimin sa më të mirë dhe efektiv të emigrantëve dhe fëmijëve refugjatë në drejtim të arsimit dhe formimit të tyre. Për këtë qëllim, ne bashkëpunojmë me organizata dhe institucione që merren me refugjatë dhe emigrantë, si Qendra e Imigracionit e Bashkisë Heraklion dhe Bashkisë Maleviziou dhe organizata të tjera joqeveritare. Drejtoria ndihmon gjithashtu në gjetjen e shkollës së duhur për nxënësit në bazë të adresës së tyre të banimit dhe më pas komunikon me shkollën përkatëse për të lehtësuar regjistrimin e këtyre nxënësve. Gjatë gjithë kësaj periudhe ekziston bashkëpunim i ngushtë si me punonjësit socialë, me edukatorët specialë dhe me koordinatorët e arsimit për të lehtësuar dhe shërbyer në mënyrë të përshtatshme nevojat mësimore të nxënësve. Për shembull, në të kaluarën e afërt kishte nxënës me nevoja speciale arsimore dhe Drejtoria ndihmoi në lehtësimin e procedurave që këta nxënës të merrnin mbështetje suplementare që kishin nevojë.

